



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

REKTORI

Nr. 2230 Prot

Shkodër, më 16 .10 .2024

N J O F T I M

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" shpallet konkursi për një vend të lirë pune, për kategorinë staf akademik pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore, Departamenti i Matematikës, në pozicionin lektor/e ose asistent-lektor/e me kohë të plotë për vitin akademik 2024-2025, programi i studimit bachelor "Informatikë", bachelor "Matematikë" për seminarët dhe laboratorët e lëndëve "C++" dhe "Bazë të dhënash".

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere specifike :

1. Të kenë kryer të gjitha ciklet e studimit në fushen e "Informatikës" në sistemin me kohë të plotë.
2. Nota mesatare e përgjithshme e studimeve që në nivelet e kornizës shqiptare të kualifikimeve (kshk) i përket nivelit 6 (Bachelor/Program studimi i nivelit të parë), duhet të jetë jo më e ulët se 8.5 (tetë pikë pesë) dhe nota mesatare e grupit të lëndëve për të cilat konkurrohet të jetë jo më e ulët se 9 (nëntë).
3. Nota mesatare e përgjithshme e studimeve që në nivelet e kornizës shqiptare të kualifikimeve (kshk) i përket nivelit 7 (Master i Shkencave, Master i arteve/Master i arteve të bukura/Program studimi i nivelit të dytë, Program studimi i integruar i ciklit të dytë ose Program studimi 4-vjeçar) duhet të jetë jo më e ulët se 8.5 (tetë pikë pesë) dhe nota mesatare e grupit të lëndëve për të cilat konkurrohet të jetë jo më e ulët se 9 (nëntë).
4. Kandidatët e kategorisë "Lektor" duhet të kenë mbaruar studimet që në nivelin e kornizës së kualifikimeve (kksh) i përket nivelit 8 (Doktoratë, Shkollë pasuniversitare studimesh të thelluara ose të ketë titullin Docent).
5. Kandidati që konkurron duhet ti ketë dhënë domosdoshmërisht provim, në ciklin e parë ose të dytë të studimit, lëndët për të cilat pretendon të jetë mësimdhënës.
6. Të njohë një nga pesë gjuhët e huaja të BE-së, me notë jo më të ulët se 8 (tetë) të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore ose të njohur nga Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për gjuhët në nivelin C1. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
7. Të kenë eksperiencë pune në mësimdhënie në arsimin e lartë.
8. Të kenë botime.
9. Kandidatët e kategorisë "Profesor" konkurojnë vetëm me dosje. Kur paraqiten dy kandidatë të kategorisë "Profesor" përzgjedhja bëhet konform nenit 11 të "Rregullores së punësimit"

Kandidatët për pedagogë duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme :

Sheshi 2 Prilli, Shkodër, +355(22)800651, <http://www.unishk.edu.al>, info@unishk.edu.al

1. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar.
2. Të zotërojnë aftësi profesionale specifike për vendin e punës për të cilin konkurrojnë.
3. Të kenë aftësinë e punës në grup dhe aftësi komunikimi profesional.
4. Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale.
5. Të mos jenë larguar nga USH "L.Gurakuqi" pa miratimin e këtij të fundit.
6. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.
7. Të mos kenë prishur në mënyrë publike imazhin e USH "L.Gurakuqi".
8. Të mos kenë lidhje familjare (bashkëshort/bashkjetues, bir, bijë dhe fëmijët e tyre), gjinie (prindër, motër e vëlla dhe fëmijët e tyre) me punonjës ekzistues brenda të njëjtes njësi bazë/drejtorisë ku kërkohet të punësohen.

Kandidatët për pedagogë duhet të paraqesin këto dokumente :

1. Të aplikojë "on-line" në faqen zyrtare të USH në internet në adresen www.unishk.edu.al (rubrika Njoftime për punësim- pedagog të brendshëm)
2. Letër-motivimi dhe jetëshkrim (CV) me foto personale.
3. Fotokopje të noterizuara të diplomave universitare (Bachelor dhe MSH ose DIND) në specialitetin e lartpërmendur dhe lista përkatëse e notave të noterizuara. Për diplomat e fituara në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet certifikata e njohjes nga MASR.
4. Fotokopje e noterizuar e gradës shkencore "Doktor" në specialitetin e lartpërmendur dhe/ose titujve akademikë (nëse ka të tilla).
5. Tre rekomandime nga të cilat të paktën dy prej mësimdhënësit me tituj shkencorë në profilin përkatës dhe një rekomandim nga punëdhënësi i fundit.
6. Fotokopje të artikujve të botuar, teksteve universitare apo parauniversitare, projekte shkencore, punime të tjera.
7. Dëshmi e gjuhës së huaj të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore ose fotokopje e noterizuar.
8. Dëshmi për kualifikime të ndryshme, pjesëmarrje në konferenca, seminare, workshop etj.
9. Dëshmi e gjendjes gjyqsore (dëshmi penalteti + vërtetim gjykatë + vërtetim prokurorie + vërtetim nga zyra e përmbartimit)
10. Dëshmi e gjendjes mjeksore (kartë shëndeti + librezë shëndetsore + raport mjeko-ligjor për aftësi në punë + certifikatë vaksinimi anti-Covid)
11. Vërtetim nga qendra e punës në të cilën ka punuar ose punon (fotokopje e noterizuar e librezës së punës nëse ka) dhe/ose vërtetim papunësie nga Zyra e punës.
12. Deklaratë që provon kushtet e pikës 3/c të nenit 5 të rregullores së posaçme të Universitetit "Për punësimin në USH" (për mos-lidhje farefisnore).
13. Certifikatë familjare dhe fotokopje e pasaportës ose letërnjoftimit ID.
14. Vërtetim rajoni për adresen/rezidencën e banimit (kontratë qiramarrje).

Shënim :

- Kontrata e punës do të jetë me afat të pacaktuar për kategorinë "Lektor" dhe me afat 1 – vjeçar (vit akademik) me të drejtë rinovimi për asistent-pedagogun dhe/ose "Doktorin e Shkencave" që nuk ka së paku tre vite eksperiencë në mësimdhënie para ose pas fitimit të gradës.
- Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, dokumentacionin e mësipërm bashkë me një listë përmbledhëse të këtij dokumentacioni të firmosur, brenda dy javëve nga publikimi i njoftimit në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Konkursi do të zhvillohet me dosje, dhe/ose testim, dhe/ose intervistë brenda tri javëve nga publikimi i njoftimit, sipas orarit që do të përcaktojë departamenti përkatës.
- Kandidatët që kualifikohen do të njoftohen me e-mail nga kryetari i komisionit ad-hoc.
- Për hollësi të mëtejshme, si programi, mënyra e zhvillimit të konkursit dhe ora e saktë, t'i drejtoheni dekonatit përkatës dhe/ose Sektorit të Burimeve Njerëzore në Rektorat.

Prof. dr. Tonin GHURAJ

Sheshi 2 Prilli, Shkodër, +355(22)800651, <http://www.unishk.edu.al>, info@unishk.edu.al

